

Mundësi punësimi:

Avokat/e pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare

Tiranë, më 09.06.2020

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare njofton të gjithë personat e interesuar se shpall pozicionin vakant për avokat/e për periudhën Qershor – Dhjetor 2020.

Kandidatët duhet të përmbushin kriteret e mëposhtme:

- Të kenë përfunduar studimet për drejtësi, të barazvlefshme me sistemin Bachelor plus Master;
- Të jenë pajisur me licensën e avokatit/es;
- Të ketë përvoja të mëparshme në koordinimin e projekteve;
- Të njohin programet bazë të kompjuterit;
- Të kenë njohuri të gjuhës angleze;

Preferohen:

- Të kenë eksperiencë pune në ushtrimin e profesionit të avokatit;
- Të kenë pasur eksperiencë si anëtarë/e të skuadrave pro-bono pranë Qendrës për Nisma Ligjore Qytetare;
- Të kenë pasur eksperiencë si avokat/e në çështje familjare, të dhunës me bazë gjinore dhe diskriminimit gjinor;
- Të kenë pasur eksperiencë pune pranë organizatave jofitimprurëse që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut;
- Të ketë pasur eksperiencë të mëparshme në kryerjen e procedurave të prokurimeve të përcaktuara në prag dhe udhëzimet përkatëse në projektet që mbështeten nga BE;

Në përputhje me Nenin 142/2 të Kodit të Punës, të ndryshuar, muaji i parë i punës do të konsiderohet si kohë prove.

Me qëllim aplikimin në këtë pozicion kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:

1. CV e kandidatit/es;
2. Kopje të Diplomës, të shoqëruar me kopje të listës së notave të studimeve Bachelor dhe Master, ose ekuivalente me to;
3. Dëshmia e licencës së Avokatit;
4. Dokument që provon njohuritë e gjuhës angleze;
5. Dokument që provon eksperiencë të mëparshme në koordinimin e projekteve;
6. Çdo dokumentacion të nevojshëm që tregon kualifikimet e kandidatit/es;

Afati i fundit i aplikimeve do të jetë data 22 qershor 2020, ora 16.00.

Dokumentacioni mund të dërgohet i skanuar në adresën e emailit avokatore2@yahoo.com ose, të depozitohet pranë zyrave të Qendrës për Nisma Ligjore me adresë Rruga “Vaso Pasha” Pll.12, Shk.1, Ap. 1 Tiranë.

Kandidatët e shortlistuar do të njoftohen dhe thirren në një intervistë.